



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika (d) dhe nenit 51.1 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja (d), dhe të nenit 44, paragrafi 44.1 shkronja (a) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110–391, të dt. 25.02.2010, si dhe nenit 4 të Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-273423, dt.9.12.2014, Kuvendi i Kryeqytetit në mbledhjen e mbajtur më . .2026, merr këtë

**V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR FORMIMIN
E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

1. MIRATOHET ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit, nr. 01-020/04-31224/26, i datës 2.3.2026, për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Ndryshohet pika II e Vendimit të lartcekur, ashtu që anëtarja e deritanishme, znj. Jeta Rafuna-Hasani, zëvendësohet me anëtarin e re, znj. -----, z. Leutrim Retkoceri zëvendësohet me z.-----.
3. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

**KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina**



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), neni 40 paragrafi 1 dhe 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligji Nr. 10/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 neni 11 paragrafi 1 dhe 2, dhe neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.28/2008, i datës 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën **.2026** miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e lëvizjes së numrit të lejuar të të punësuarve në kuadër të Drejtorisë Komunale të Arsimit

Neni 1

Miratohet bartja e njëzet e katër (24) numrave të lejuar për punësim nga kategoria Arsimi i Mesëm i Lartë, me kod buxhetor 94350, si dhe njëmbëdhjetë (11) numrave nga kategoria Arsimi i Mesëm i Ulët, me kod buxhetor 93150, në kategorinë Arsimi Parashkollor, me kod buxhetor 92310, në pajtim me nenin 11, pika 2 të Ligjit Nr. 10/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 2

Bartja e numrit të lejuar për punësim nga niveli i arsimit të mesëm të lartë dhe të mesëm të ulët në nivelin parafillor bëhet për shkak të nevojave të paraqitura në institucionet edukativo-arsimore, me qëllim të sigurimit të funksionimit të rregullt të procesit edukativo-arsimor dhe përmbushjes së nevojave organizative e funksionale të Drejtorisë Komunale të Arsimit, pa tejkaluar numrin e përgjithshëm të të punësuarve të miratuar me ligj.

Neni 3

Obligohet Kryetari i Komunës dhe Drejtoria Komunale e Arsimit të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nën mbikëqyrje të Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

Kërkesë për qartësimin e numrit të saktë të pozitive për bartje të normave

Të nderuar përfaqësues të Kuvendit Komunal,

Drejtoria Komunale e Arsimit ju shpreh falënderimin për shqyrtimin dhe aprovimin në seancën e mëhershme të kërkesës për bartjen e normave nga niveli i arsimit të mesëm të lartë dhe arsimit fillor e të mesëm të ulët në nivelin parafillor, me qëllim të përmbushjes së nevojave organizative dhe funksionale të sistemit edukativo-arsimor në Kryeqytet.

Ju njoftojmë se, pas miratimit të vendimit nga Kuvendi Komunal, Drejtoria e Arsimit ka proceduar kërkesën për zbatimin e tij pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve – Thesarit. Mirëpo, nga Ministria e Financave është kërkuar që vendimi të qartësohet dhe të specifikohet numri i saktë i pozitive që barten ndërmjet niveleve arsimore, me qëllim të funksionalizimit të tyre në sistemin e pagesave.

Andaj, duke u bazuar në gjendjen e krijuar sipas të dhënave të qershor 2026 dhe në nevojat e institucioneve të edukimit parafillor, kërkojmë që Kuvendi Komunal të miratojë dhe specifikojë qartë bartjen e gjithsej tridhjetë e pesë (35) numrave të lejuar për punësim, si në vijim:

- Njëzet e katër (24) numra nga kategoria e arsimit të mesëm të lartë;
- njëmbëdhjetë (11) numra nga kategoria e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët;

në kategorinë e arsimit parafillor.

Kjo bartje kërkohet të bëhet në pajtim me nenin 11, pika 2 të Ligjit Nr. 10/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, pa tejkaluar numrin e përgjithshëm të të punësuarve të miratuar me ligj.

Duke pasur parasysh rëndësinë e funksionalizimit të këtyre pozitive për institucionet parafillore, kërkojmë nga Kuvendi Komunal që të shqyrtojë dhe miratojë këtë qartësim/specifikim, me qëllim të funksionalizimit të pozitive të miratuara dhe mundësimin të sistemit të edukatoreve, të cilat që nga shtatori i vitit 2025 kanë mbetur të pasistemuara, ndonëse institucionet parashkollore vazhdimisht kanë shprehur nevojë për staf edukativ..



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



PROPOZIM

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**) të Ligjit nr. 03/L– 40, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04 qershor 2008), të Rregullores 01-110/05-206977/22 e dt. 26.09.2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d**) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më _____, merr këtë

VENDIM

PËR CAKTIMIN E KOMISIONIT PËR UDHËHEQJEN DHE KOORDINIMIN E PUNËS NË TERREN PËR PËRZGJEDHJEN E KËSHILLAVE TË FSHATRAVE, VENDBANIMEVE DHE LAGJEVE URBANE

- I.** CAKTOHEN anëtarët e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
- II.** Anëtarë të komisionit si në pikën I të këtij vendimi janë:
 1. (anëtar i KK);
 2. (anëtar i KK);
 3. (anëtar i KK);
 4. (anëtar i KK);
 5. (anëtar nga Ekzekutivi);
 6. (anëtar nga shoqëria civile);
 7. (përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal).
- III.** Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i komisionit janë të cekura në Rregulloren 01-110/05-206977/22 e dt. 26.09.2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe Rregulloren nr. 01-030/01-34831/18 e dt. 06.06.2018 për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.
- IV.** Komisioni i cekur si në pikën II të këtij Vendimi do të kompensohet në vlerë prej 300 € në muaj nga kategoria mallra dhe shërbime, për muajt sa zgjat procesi i përzgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Pas kësaj periudhe Komisioni nuk kompensohet.
- V.** Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
, 2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova — Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

PRISHTINA



Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenit 40 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53 të Statutit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, në ndërlidhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, i propozohet Kuvendit të Kryeqytetit për shqyrtim dhe miratim ky:

PROPOZIM – VENDIM
PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONEVE PËR REKRUTIMIN E DREJTORËVE
DHE ZËVENDËSDREJTORËVE TË INSTITUCIONEVE EDUKATIVO-ARSIMORE DHE
AFTËSUESE NË KRYEQYTET

Neni 1

Qëllimi

Përmes këtij vendimi, Kuvendi i Kryeqytetit cakton anëtarët e komisioneve profesionale për rekrutimin dhe përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve publike edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare në Kryeqytet.

Neni 2

Përbërja e Komisioneve

Komisionet e rekrutimit për secilin institucion edukativo-arsimor dhe aftësues për parashkollor, nivelin e fillor dhe të mesëm të ulët, nivelin e mesëm të lartë dhe shkollave profesionale/IAAP-ve do të kenë përbërjen e rregullt prej tre (3) anëtarëve dhe dy (2) vëzhguesve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse.

Përbërja e komisioneve është si vijon:

- Dy (2) përfaqësues nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), të rekomanduar nga DKA, si në vijim:
 1. znj. Fitnete Tutuli – Zyrtare e lartë për arsim të mesëm të lartë në Drejtorinë Komunale të Arsimit;
 2. z. Isak Bregaj – Drejtor me performancë të lartë; në rast të mungesës së tij, anëtar i komisionit do të jetë z. Egzon Gashi – Ekspert i Arsimit.

- Një (1) përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), i caktuar nga MASHTI.
- Një (1) përfaqësues nga Këshilli i Prindërve në nivel të institucionit përkatës, i nominuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës (KDSH).

Neni 3

Detyrat dhe Përgjegjësitë

Komisionet e emëruara sipas këtij vendimi kanë për detyrë të udhëheqin tërë procesin e rekrutimit, duke përfshirë:

1. Shqyrtimin dhe verifikimin e aplikacioneve të kandidatëve;
2. Hartimin e listave të ngushta të kandidatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara;
3. Organizimin dhe zhvillimin e testimit me shkrim dhe intervistave me gojë;
4. Rekomandimin e kandidatëve më të suksesshëm te Kryetari i Kryeqytetit për emërim.

Neni 4

Kompensimi

Anëtarët e komisioneve kanë të drejtë në kompensim për punën e kryer, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mjetet buxhetore të planifikuara nga Kryeqyteti për këtë qëllim.

Neni 5

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Kryetari i Kryeqytetit.

Neni 6

Hyrja në Fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT

Fehmi Kupina

Arsyetim

Ky propozim-vendim i paraqitet Kuvendit të Kryeqytetit për shqyrtim dhe miratim, me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes së procesit edukativo-arsimor dhe plotësimit të pozitave udhëheqëse në institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese, të cilat aktualisht menaxhohen nga ushtrues detyre ose kanë kontrata të skaduara. Procesi i rekrutimit do të zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar transparencë, meritokraci dhe mundësi monitorimi nga shoqëria civile dhe mediat.



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L– 40, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), të dispozitave të nenit 5, paragrafi 5.2 dhe nenit 8, paragrafi 8.2 të Ligjit nr. 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më:2026, merr këtë:

**VENDIM
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR CAKTIMIN E
ANËTARËVE NË KOMISIONET E AKSIONARËVE TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE
TË KOMUNËS SË PRISHTINËS**

I.

MIRATOHET plotësimi dhe ndryshimi i Vendimit nr. **01-020/04-62823/26**, të dt. **28.4.2026** për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës.

II.

Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, anëtarë e caktuar në komisionet e aksionarëve janë:

1. Ndërmarrja publike “Sport – Marketing”, SHA;

- 1.**
- 2.**

III.

Komisionet komunale të aksionarëve kanë të drejtë të veprojnë në emër të Komunës dhe duhet të veprojnë në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi tridhjetë (**30**) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (**7**) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e kryeqytetit.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

, më .2026

KRYESUES I KUVENDIT

Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



PROPOZIM

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për vetëqeverisje lokale dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur me __/__/2026, merr këtë :

V E N D I M

1. Miratohet ndarja e mjeteve financiare për NPL “Prishtina Parking” SH.A.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, shuma e mjeteve të ndara është në vlerë prej 100.000,00 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere – kodi 16306.
3. Sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, pjesë përbërëse janë: kërkesa e parashtruar për subvencionim nga NPL “Prishtina Parking” Sh.A. 02 nr. 343 e datës 25.06.2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtoria e Financave.
5. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

ARSYETIM

Bazuar në kërkesën e parashtruar nga NPL “Prishtina Parking” Sh.A. sipas të cilës rezulton se ndërmarrja është përballur me rënie të ndjeshme të të hyrave si pasojë e shfuqizimit të një pjese të Rregullores nga Gjykata Supreme e që ka ndikuar drejtpërdrejt në gjendjen e saj financiare dhe në aftësinë për përmbushjen e obligimeve të akumuluar. Në këto rrethana, subvencionimi nga Komuna e Prishtinës në vlerë prej 100,000 € është i nevojshëm për mbulimin e obligimeve emergjente dhe sigurimin e vazhdimësisë së operimit.

PRISHTINA



**Ndërmarrja Publike Lokale
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë**



PRISHTINA NPL "PRISHTINA PARKING" SH.A Prishtinë	
25-06-2026	
02	No. 343

Drejtuar: Kuvendit Komunal Prishtinë

Cc Kryetarit të Komunës së Prishtinës
z. Përparim Rama

Nga Muhamet Velu – UD Kryeshef Ekzekutiv , NPL Prishtina Parking , Sh.A Prishtinë.

Lënda: Kërkesë për mbështetje financiare (subvencion).

Të nderuar ,

Në cilësinë e përfaqësuesit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Prishtina Parking", ju drejtohem me këtë kërkesë për mbështetje financiare nga Komuna e Prishtinës, me qëllim të tejkalimit të vështirësive financiare aktuale dhe garantimit të vazhdimësisë së shërbimeve publike që ndërmarrja ofron për qytetarët e Kryeqytetit.

N.P.L. "Prishtina Parking" ka vazhduar të ofrojë shërbimet e saj pa ndërprerje dhe të përmbushë përgjegjësitë operative, mirëpo gjatë vitit 2025 është përballur me një rënie të ndjeshme të të hyrave, si pasojë e shfuqizimit të një pjese të Rregullores nga Gjykata Supreme gjë që ka ndikuar drejtpërdrejt në gjendjen e saj financiare dhe në aftësinë për përmbushjen e obligimeve të akumuluar.

Aktualisht, ndërmarrja bart obligime financiare në vlerë prej rreth 900,000 euro, të cilat përfshijnë:

- Obligime që rrjedhin nga projektet e digjitalizimit dhe modernizimit të sistemit operativ;
- Obligime kontraktuale dhe operative;
- Detyrime për qira;
- Obligime ndaj Policisë së Kosovës për punët sekondare ;
- Obligime ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK);
- Obligime ndaj stafit dhe detyrime të tjera financiare të krijuara gjatë operimit të rregullt të ndërmarrjes.

Si pasojë e kësaj gjendjeje, ndërmarrja po përballë me presion të lartë financiar, ndërsa në raste të caktuara kanë filluar edhe procedurat e bllokimit të llogarive, duke rrezikuar seriozisht likuiditetin dhe funksionimin normal të saj.

Duke pasur parasysh rëndësinë e shërbimeve që ofron ndërmarrja për menaxhimin e parkingjeve publike në Kryeqytet, si dhe faktin se Komuna e Prishtinës ka mbështetur edhe më herët ndërmarrje publike përmes subvencioneve për ruajtjen e funksionalitetit dhe përmbushjen e obligimeve të tyre financiare, kërkojmë që edhe N.P.L. "Prishtina Parking" të përfshihet në këtë mbështetje institucionale.

Prandaj, kërkojmë nga Komuna e Prishtinës ndarjen e një subvencioni sipas vlersimit të buxhetit komunal të Komunës së Prishtinës me qka do të ndihmonte për :

- Shlyerjen e obligimeve të pa paguara ;
- Stabilizimin e gjendjes financiare të ndërmarrjes;
- Garantimin e pagesës së rregullt të pagave dhe obligimeve ligjore;
- Parandalimin e bllokimit të mëtejshëm të operacioneve financiare;
- Sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve publike për qytetarët e Prishtinës.

Bashkangjitur me kërkesë po ju dergojm një raport financave për të sqaruar gjendjen në të cilën ndodhemi .

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj, presim shqyrtimin pozitiv të kërkesës sonë.

Faleminderit.

Me respekt,



Muhamet Veliu

U.D. Kryeshef Ekzekutiv

N.P.L. "Prishtina Parking" Sh.A.

Adresa: Rr. "Musa Tolaj", Objekti "Donika 2", Lakrishte, Prishtinë, 10000, Kosovë

Tel: +383 38 224-228

E-mail: muhamet.veliu@prishtinaparking.net

Web: www.prishtinaparking.net

